



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MBROJTJES
MINISTRI

URDHËR

Nr. 2111, datë 04.12.2014

P Ë R

MIRATIMIN E STRATEGJISË PËR MBROJTJEN KIBERNETIKE

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 13, pika 2, germa "f" të ligjit nr. 64/2014, datë 26.06.2014 "Për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit e të komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë", si dhe nenit 12 të ligjit nr. 9000, datë 30.01.2003 "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave",

URDHËROJ:

1. Miratimin e Strategjisë për Mbrojtjen Kibernetike të përgatitur nga grupi i punës.
2. Strategjia për Mbrojtjen Kibernetike të bëhet objekt planifikimi, studimi e analize për sigurinë e sistemeve të komunikimit dhe të informacionit, që përdoren në të gjitha strukturat e Forcave të Armatosura.
3. Me këtë urdhër të njihen të gjitha Drejtoritë e Ministrisë së Mbrojtjes, Shtabit të Përgjithshëm të FA, AISM, QNOD dhe ASNI.
4. Ndjek zbatimin e këtij urdhri Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mbrojtjes dhe Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA.
5. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI

MIMI KODHELI

